

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIONE

Nr.faq/Br.str. 152
Datë/Datum. 09.08.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.08.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2018, pas shqyrtimit të rekomandimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete për vaksinimin e fëmijëve deri në moshën pesëvjeçare nga radhët e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), paragrafi 40.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për delegimin e kompetencës të Ekzekutivi i Komunës për rregullimin e kushteve dhe udhëzimeve për zgjidhjen e çështjes së vaksinimit të fëmijëve deri në moshën pesëvjeçare nga radhët e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian

1. Për delegimin e kompetencës nga Kuvendi i Komunës, të Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si autoritete përgjegjëse, që të vendosin me një akt nënligjor, 'Urdhëresës për kushtet dhe udhëzimet për zgjidhjen e çështjes rreth problemit të vaksinimit të fëmijëve deri në moshën pesëvjeçare nga radhët e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian'.
2. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë i caktohen detyrat shtesë për lëshimin e vërtetimit të vaksinimit të fëmijëve, prindërve vetëm për vazhdimin e asistencës sociale në Qendrën për Punë Sociale në Fushë-Kosovë.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencën e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim të evitimit të përhapjes të sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme.
4. Vaksinimi i fëmijëve është obligim ligjor, që duhet të realizohet nga secili prind për fëmijën e vet dhe në realizimin e këtij objekti duhet të angazhohen Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe përfaqësuesit e komuniteteve.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së
SHMS, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

